

dokument permbledhes projekti

Emertimi i Projektit:	Shqiperi: Porti i Durresit
Vendi:	Shqiperi
Numri i Project:	35862
Sektori i biznesit:	Transport
Publik/Privat:	Publik
Kategoria e Mjedisit:	B/1
Data e Bordit:	30 Maj 2007
Statusi:	Jo aktiv
Data e perfundimit te PSD:	11 Tetor 2006
Data e azhornimit te PSD:	

Pershkrimi i projektit dhe objektivat Projekti i propozuar do te rrise kapacitetin e terminalit te pasagjereve, do te permiresoje kalatat 7 dhe 8 dhe infrastrukturen qe lidhet me to ne Portin e Durresit si dhe do te permiresoje cilesine e sherbimeve qe sigurohen ne keto terminale.

Impakti i tranzicionit: Impakti i tranzicionit do te arrihet nga realizimi i ndryshimeve ne politiken e portit per tarifat dhe dividendin si dhe ne permiresimin e planifikimit te biznesit. Pavec kesaj, Porti zbaton Ligjin i ri mbi Portin, qe zvogelon nderhyrjet politike ne menaxhimin e portit duke lejuar konkurrencen e ndershme ne sherbimet e perpunimit te mallrave. Projekti i propozuar do te perqendrohet ne politiken reformatore te tarifave dhe dividendit, e cila eshte thelbesore per te mundesuar qe Autoriteti Portual i Durresit (APD) te veproje mbi baza tregetare.

Klienti: Huamarresi eshte Republika e Shqiperise ndersa klienti eshte Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve (MPPTT). Projekti do te zbatohet nga Drejtoria e Transpotit Detar e cila eshte pergjegjese per sektorin e portit.

Financimi i BERZH: Llogaritet ne 14 milion Euro.

Shuma totale e projektit: Llogaritet ne 40 milion Euro.

Ndikimi ne mjedis: Kategoria B/1. Ndertimi i nje terminali tragetesh dhe rehabilitimi i kalatave 7 dhe 8 parashikohet qe te kene nje ndikim te vogel mjedisor i cili mund te identifkohet dhe menjanohet lehtesisht me ane te nje analize mjedisore. Vleresimi mjedisor qe po kryhet do te rishikojte gjithashtu gjendjen mjedisore ne Portin e Durresit dhe ate te aktiviteteve te tanishme, per te identifikuar ndonje rrezik ekzistues ose potencial ndaj mjedisit qe vjen nga aktivitetet e tanishme. Analiza mjedisore e programit te propozuar te investimeve do te identifikojte dhe vleresojte çdo ndikim dhe perfitim potencial mjedisor ne port dhe perreth tij, perfshire dhe ekosistemin detar, qe

rrjedhin nga projekti i propozuar.

Punimet ne terminalin e trageteve perfshijne modernizimin e sherbimeve te terminalit ekzistues dhe kane te bejne teresisht me punime tokesore brenda portit. Ndikimet mjedisore qe lidhen me ndertimin parashikohen qe te jene te perkohshme dhe te kufizuara brenda zones se portit. Rritja e kapacitetit te portit do te sjelle rritje te trafikut por, megjithate, ky trafik nuk do te kaloje permes qytetit te Durrësit por do te drejtohet ne rrjetin rrugor kombetar qe nga dalja e portit. Brenda portit, infrastruktura e modernizuar do te permiresoje ne shkalle shume te larte sigurine e pasagjereve dhe mjedisin duke mbledhur kullimet vajore qe rrjedhin ne kanale te reja kullimi dhe duke i kaluar pastaj nepermjet ndaresve te posaçem.

Do te pergatitet nje Plan Menaxhimit Mjedor i plote me masa parandaluese, korrigjuese dhe permiresuese ne perputhje me standartet nderkombetare dhe kerkesat e BE ne lidhje me ceshtje te tilla si trajtimi i mbetjeve, planifikimi per ndalimin e rrjedhjes se vajrave, thellimi i portit, dhe administrimi i transportit gjate ndertimit dhe funksionimit duke patur parasysh rritjen si te trafikut tokesor ashtu dhe te atij detar.

Ky seksion do te perditesohet pas perfundimit te vleresimit te analizes mjedisore.

Bashkepunime Teknike:

Asnje.

Per mundesi konsultimi per projektet e financuara nga fondet teknike te bashkepunimit, vizitoni [procurement of consultants](#).

Personi i Kontaktit:

Elena Gordeeva, Operation Leader:
gordeeva@ebrd.com

Mundesi prokurimi ose tenderi :

Vizitoni [EBRD Procurement](#)
Pyetje: Tel: +44 20 7338 6794; Fax: +44 20 7338 7472, Email: procurement@ebrd.com

Te dhena te pergjithshme:

Pyetje per projekte te BERZHqe nuk lidhen me prokurime:
Tel: +44 20 7338 7168; Fax: +44 20 7338 7380
Email: projectenquiries@ebrd.com